



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2559, datë 27.04.2015

Për

“Miratimin e Raportit Përmbledhës të KVO-së dhe Njoftimin e fituesve të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS”, Ref. 14-2x5-10x5-2015”.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1.	Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2.	Z. Alban	Karapici	Anëtar
3.	Znj. Anila	Denaj	Anëtar
4.	Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5.	Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.M.Drushku, në mbledhjen e datës 27.04.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe enteve publike”, dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e Raportit Përmbledhës të KVO-së dhe Njoftimin e fituesve të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS”, Ref. 14-2x5-10x5-2015”.

BAZA LIGJORE:

1. Ligji Nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative”.
2. Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
3. VKM Nr.1252 datë 10.09.2008 pika 19.1 “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënie të drejtës të përdorimit të frekuencave”, i ndryshuar.
4. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

- Raporti përmbledhës i procedurës së tenderit publik protokolluar me nr.810/2, datë 23.04.2015,
- Projektvendim i KD i formatuar dhe arsyetuar;
- Njoftimi i fituesit sipas shtojces 16-Formulari i Njoftimit te Fituesit
- Shtojca 17- Formulari i Botimit te Fituesit
- Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Dokumentacioni:

- a) **Raporti përmbledhës** i hartuar nga KVO është në përputhje me pikën 15.10, Kreu III të VKM nr.1252, datë 10.09.2008 “Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave”, i ndryshuar;
- b) **Shtojca 16- Formulari i Njoftimit të Fituesit** të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “*Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS*”, Ref. 14-2x5-10x5-2015” është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës.
- c) **Shtojca 17- Formulari i Botimit të Fituesit** është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës dhe me Dokumentin e Tenderit.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë:

- VKM Nr.1252 datë 10.09.2008 pika 1.3 “Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave”, i ndryshuar
- Dokumentin e Tenderit;
- Raportin përmbledhës së procedurës së tenderit publik protokolluar me nr.810/2, datë 23.04.2015,
- Rregulloren e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP;

V E N D O S:

1. Të miratojë Raportin Përmbledhës nr.810/2, datë 23.04.2015;

2. Të miratojë Njoftimin e Fituesve, sipas dokumenteve bashkëlidhur;
3. Të bëhet publikimi i njoftimit të fituesve në faqen e internetit të AKEP, www.akep.al
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Anila DENAJ** _____
3. **Ketrin TOPÇIU** _____
4. **Klarina ALLUSHI** _____